

11 Prill 2016

## Gripi në Shqipëri për Sezonin 2015 -2016, Java 13, 28 Mars – 3 Prill

### Përmbledhje

Nga të dhënat e raportimit sipas survejancës së infeksioneve akute respiratore të sipërme dhe të poshtme të sistemit ALERT, survejancës sentinel të sëmundjeve të ngjashme me Gripin në rrethin e Tiranës, vlerësimin të infeksioneve respiratore tek fëmijët 0-1 vjeç dhe survejancës së infeksioneve respiratore akute të rënda në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, **vërejmë se kemi të bëjmë me një aktivitet mesatar të gripit në krahasim me sezonet e mëparshme. Në javën e trembëdhjetë të vitit 2016 kemi një rënie të numrit të mostrave pozitive për grip nga survejanca sentinel për dhe SRRA (Sëmundje e Rëndë Respiratore Akute), ku mbizotëron tipi B.**

Në rajonin European dhe vendet fqinje të Europës Jug Lindore përqindja e mostrave pozitive është rritur në javën 51 të vitit 2015 duke na treguar që **sezoni i gripit në rajonin tonë ka filluar në javën 51 të 2015. Kjo situatë është pak a shumë e ngjashme edhe në vendin tonë ku u gjet pozitiviteti i mostrave në javën 53 të 2015 dhe javën 1 dhe 2 të vitit 2016.**

Megjithatë për javën e trembëdhjetë 88% e vende kanë raportuar prirje në rënie aktiviteti i gripit mbetet i përhapur pjesën perëndimore të rajonit European.

Në rajonin European për javën e trembëdhjetë të 2016 nga survejanca sentinel mbizotëron virusi A në 59% të totalit të mostrave të testuara.

Virusi A(H1N1) pdm09 mbizotëron në 83% të mostrave pozitive të tipit A. Në shumë vende të rajonit ashtu si edhe në Shqipëri vërehet një ritje e përqindjes të mostrave pozitive për virusin B (41%).

Gjithashtu është vënë re një rënie e numrit të rasteve me sëmundje të rëndë respiratore kryesisht në grupmoshën 15-64 vjeç prej virusit A(H1N1)pdm09. **Në këtë sezon, numri i rasteve të raportuara me sëmundje të rëndë respiratore kryesisht prej virusit A(H1N1)pdm09 është më i lartë krahasuar me sezonet e mëparshme.**

**Analiza filogjenetike e viruseve A(H1N1) pdm09 që po qarkullojnë në këtë sezon (2015 -2016) tregon se ka në qarkullim një klaster të ri të një nëngrupi gjenetik, 6B, që do të thotë se kemi të bëjmë me një variant të ri të këtij virusi. Ky variant është zbuluar fillimisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në Nju Jork në Gusht të 2015, dhe është vënë re në disa raste në këtë sezon në Mbretërinë e Bashkuar, Japoni, Arabi Saudite dhe sidomos Iran ku është vënë re një numër më i lartë rastesh të rënda dhe vdekje. Ky variant i këtij virusi të gripit është i lidhur me forma të rënda**

të sëmundjes dhe vdekje. Po kështu mendohet se është ky lloj varianti që lidhet me format e rënda të Gripit që janë vënë re javët e fundit në Turqi, Ukrainë, Rusi, Armeni dhe Izrael.


Gjithsesi shumica e viruseve A(H1N1)pdm09, A(H3N2) dhe B të karakterizuar deri më tani janë të ngjashëm me shtamet e rekomanduara për tu përfshirë në vaksinat trevalente (përsa i përket perfaqësuesve të linjës gjenetike B/Yamagata) dhe katërvalente (përfshirë viruse përfaqësues nga të dyja linjat gjenetike B/Viktoria dhe B/Yamagata) të hemisferës veriore (*shiko më poshtë*). Vaksinat trevalente që janë në përdorim nga vendet e rajonit nuk mbulojnë shumicën e viruseve B/Viktoria që po qarkullojnë në këtë sezon. (<http://flunewseurope.org/VirusCharacteristics>)

Përbërja e vaksinës së gripit për hemisferin verior për sezonin 2015 -2016 është:

- A/California/7/2009 (H1N1)pdm09-like virus;
- A/Switzerland/9715293/2013 (H3N2)-like virus;
- B/Phuket/3073/2013-like virus.


Vaksina katërvalente përmban dy viruse B të Gripit dhe përveç viruseve të mësipërme përmban tipin B/Brisbane/60/2008-like virus.

### 1. Prirja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme në javët 1 – 13 të vitit 2015 dhe 2016 (numri i rasteve).




Në javën e 13-të të vitit 2016 vërehet trend në ritje i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 3% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

**2. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 12 dhe 13 të vitit 2016. Incidenca (raste/10.000)**



**3. Numri total i mostrave të ardhura sipas javëve dhe rezultati laboratorik 2015-2016**




Prej javës së 1<sup>-rë</sup> të muajit Tetor 2015 deri më datën 10 Prill 2016 kanë ardhur në ISHP dhe janë testuar 823 mostra nga persona të dyshuar përgrip. Para pranimit në laborator kryhet rregullisht monitorimi i cilesisë së mostrës sipas protokolleve standarte. Të gjitha mostrat e ardhura në javën e katërt janë testuar me metodën molekulare të Real-Time RT PCR si dhe do të vijojë izolimi në kulturat qelizore të linjës MDCK. Disa mostra të përzgjedhura nga raste të rënda dhe nga grupmosha të ndryshme do të dërgohen në qendrat e referencës së OBSH-së për analiza të mëtejshme filogjenetike.

Në total, nga 823 mostrat e testuara, 269 (33%) kanë rezultuar pozitive për viruset e gripit.

#### Nga 269 mostrat pozitive:

- 133 (52%) mostra kanë rezultuar me virusin A dhe 136 (51%) me virusin B
- Nga 133 mostra me virusin A, 128 (96%) e tyre janë të nëntipit A/H1pdm09 (128/133) dhe 5 (4%) mostra të nëntipit A/H3 (5/133).
- Nga karakterizimi genotipik i viruseve të tipit B të testuar, rezulton që janë të grupit B/Victoria


#### 4. Numri i rasteve SARI (SRRA dhe STRRA) sipas javëve dhe rezultatit laboratorik



Nga totali prej 823 mostrash të ardhura në ISHP 682 ose 83% e mostrave janë SARI [(SRRA: 510 (75%) + STRRA: 172 (25%)].


238 ose 35% e mostrave SARI janë pozitive për viruset e Gripit (238/682).

### 5. Numri i rasteve ILI sipas javëve dhe rezultati laboratorik




Nga totali prej 823 mostrash të ardhura në ISHP 131 mostra ose 16% e tyre janë ILI. 31 ose 24% e mostrave ILI janë pozitive për viruset e Gripit (31/131).

### 6. Shpërndarja e numrit total të rasteve sipas grup-moshës




Vërehet që numri më i madh i mostrave pozitive janë në grupmoshën 5-14 vjeç me 31 (38%) mostra, 15-24 vjeç me 44 (39%) mostra, 25-44 vjeç me 83 (42%) mostra dhe në grupmoshën 45-59 vjeç me 41 (36%) mostra.

## 7. Sëmundje e Rëndë Respiratore Akute (STRRA)



172 (25%) prej 682 pacientëve SARI të dyshuar për Grip kanë paraqitur komplikacione (STRRA).


## 8. Shpërndarja e rasteve STRRA sipas grupmoshës



Numri më i madh i rasteve STRRA është në grupmoshën <1 vjeç, me 44 (26%) dhe në grupmoshën 60+vjeç me 48 (28%). 36 (21%) e mostrave STRRA kanë rezultuar pozitive për viruset e Gripit.


Numri më i madh i mostrave pozitive është në grupmoshën 15-24 vjeç me 4 (50%) mostra, 25-44 vjeç me 8 (47%) mostra, 45-59 vjeç 7 (26%) mostra dhe 60+vjeç, 12 (25%) mostra.

### 9. Shpërndarja e rasteve STRRA sipas vendit të raportimit




Numri më i madh i rasteve është raportuar nga SUSM 68 (40%), spitali i rrethit të Durrësit, 42 (24%) dhe spitali i rrethit të Vlorës 33 (19%) e totalit të rasteve. Numri më i madh i mostrave pozitive është në SUSM, me 22 (32%) mostra, ndjekur nga spitali Infektiv me 4 (19%) mostra.

**10. Numri total i mostrave sipas vendit të marrjes dhe rezultatit laboratorik**





**11. Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000**




Niveli i infeksioneve respiratore akute (ARI) paraqet aktivitet sezonal normal

Në javën 13/2016 aktiviteti i ARI paraqet:



- prirje në rënie
- aktivitet gjeografik të përhapur
- intensitet të ulët
- impakt të ulët

**12. Kurba epidemike dhe infeksionet respiratore sipas javëve (ARI raste/100.000)**



Vihet re se prirja e numrit të mostrave të marra ndjek atë të ARI.

**13. Llojet e Viruseve të Gripit që qarkullojnë në Kontinentin European, java 13/2016 sipas platformës europiane të raportimit TESSY(www.ecdc.eu).**



Rasti klasifikohet si SRRA sipas përkufizimit të OBSH dhe si STRRA (Sëmundje tepër e rëndë respiratore akute) sipas klasifikimit tonë për të gjitha rastet që kanë nevojë për shtrim në repartet e terapisë intensive dhe kanë nevojë për oksigjenim.